

# FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

## Sikaplan® TM-15

### MEMBRANË POLIMERE FPO PËR HIDROIZOLIM TARRACE/ ÇATIE ME MBËRTHIM MEKANIK

#### PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sikaplan® TM-15 (trashësi 1.5 mm) është membranë hidroizoluese e përforcuar me poliester, me shumë shtresa dhe sintetike, me bazë poliolefinash fleksibël të cilësisë së lartë (FPO) që përmban stabilizues të rrezeve UV dhe ngadalësues të zjarrit sipas EN 13956. Sikaplan® TM-15 është membranë që mund të saldohet me ajër të nxehtë, e krijuar për ekspozim të drejtpërdrejtë dhe për përdorim në të gjitha kushtet klimaterike globale.

#### PËRDORIMET

Membranë për hidroizolim:

- Sisteme të tarracave / çatie me mbërthim mekanik

#### KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Rezistencë ndaj rrezatimit të përhershëm UV
- Rezistencë ndaj ekspozimit të përhershëm ndaj erës
- Rezistencë ndaj të gjitha ndikimeve të zakonshme të mjedisit
- Rezistencë ndaj mikroorganizmave
- Kompatibël me bitumin e vjetër
- Saldim me ajër të nxehtë pas përdorimit e zjarrit
- I riciklueshëm

#### INFORMACIONE MBI MJEDISIN

- Pajtueshmëri me LEED v4 SSc 5 (Opsioni 1): Heat Island Reduction - Roof (vetëm ngjyra traffic white).
- Pajtueshmëri me LEED v4 MRc 2 (Opsioni 1): Pajtueshmëri me LEED v4 MRc 2 (Opsioni 1): Building Product Disclosure and Optimization – Environmental Product Declarations.
- Pajtueshmëri me LEED v4 MRc 3 (Opsioni 2): Building Product Disclosure and Optimization - Sourcing of Raw Materials.
- Pajtueshmëri me LEED v4 MRc 4 (Opsioni 2): Building Product Disclosure and Optimization - Material Ingredients.
- Pajtueshmëri me LEED v2009 SSc 7.2 (Opsioni 1): Heat Island Effect - Roof (vetëm ngjyra traffic white).
- Pajtueshmëri me LEED v2009 MRc 4 (Opsioni 2): Recycled content

#### MIRATIME / STANDARDE

Sikaplan® TM-15 është krijuar dhe prodhuar për të plotësuar shumicën e standardeve të njohura ndërkombëtare.

- Membrana polimere për hidroizolim tarrace/ çatie sipas EN 13956, certifikuar nga organi i njoftuar 1213-CPD-4855 dhe mbart markën CE.
- Reagimi në zjarr sipas EN 13501-1.
- Performanca në zjarr të jashtëm testuar sipas EN 1187 dhe klasifikuar sipas EN 13501-5: BROOF (t1).
- Miratimi i përbashkët i fabrikës (FM): 4470.
- Sistem i menaxhimit të cilësisë në përputhje me EN ISO 9001/14001.

## INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

<b>Ambalazhi</b>	Rulonat standardë Sikaplan® TM-15 janë të mbështjellë individualisht në fletë metalike të verdhë PE.		
	Gjatësi ruloni:	20.00 m	
	Gjerësi ruloni:	2.00 m	
	Peshë ruloni:	± 66.00 kg	
<b>Paraqitja / Ngjyra</b>	Sipërfaqja:	mat	
	<b>Ngjyra:</b>		
	Sipërfaqja e sipërme:	e bardhë (afërsisht RAL 9016)	
	Sipërfaqja e poshtme:	e zezë	
<b>Jetëgjatësia</b>	5 vjet nga data e prodhimit në ambalazhin original, të pahapur dhe të padëmtuar.		
<b>Kushtet e magazinimit</b>	Rulonat duhet të magazinohen midis +5°C dhe +30°C në pozicion horizontal në paletë, të mbrojtur nga rrezatimi i drejtpërdrejtë diellor, shiu dhe dëbora. Mos vendosni paletat e rulonave njëra mbi tjetrën apo materiale të tjera gjatë transportit ose magazinimit.		
<b>Deklarata e produktit</b>	EN 13956		
<b>Defekte të dukshme</b>	Nuk ka	(EN 1850-2)	
<b>Gjatësia</b>	20 m (-0 % / +5 %)	(EN 1848-2)	
<b>Gjerësia</b>	2 m (-0.5 % / +1 %)	(EN 1848-2)	
<b>Trashësia efektive</b>	1.50 mm (-5 % / +10 %)	(EN 1849-2)	
<b>Drejtvijësia</b>	≤ 30 mm	(EN 1848-2)	
<b>Rrafshësia</b>	≤ 10 mm	(EN 1848-2)	
<b>Masa për njësi sipërfaqeje</b>	1.65 kg/m <sup>2</sup> (-5 % / +10 %)	(EN 1849-2)	
<b>TË DHËNA TEKNIKE</b>			
<b>Rezistenca ndaj goditjes</b>	nënshtresë e fortë	≥ 700 mm	(EN 12691)
	nënshtresë e butë	≥ 900 mm	
<b>Rezistenca ndaj breshërit</b>	nënshtresë e papërkulshme	≥ 22 m/s	(EN 13583)
	nënshtresë fleksibël	≥ 30 m/s	
<b>Rezistenca ndaj ngarkesës statike</b>	nënshtresë e butë	≥ 20 kg	(EN 12730)
	nënshtresë e papërkulshme	≥ 20 kg	
<b>Rezistenca ndaj tërheqjes</b>	gjatësore (md) <sup>1)</sup>	≥ 1100 N/50 mm	(EN 12311-2)
	tërthore (cmd) <sup>2)</sup>	≥ 1100 N/50 mm	
1) md = machine direction 2) cmd = cross machine direction			
<b>Zgjatimi</b>	gjatësor (md) <sup>1)</sup>	≥ 13 %	(EN 12311-2)
	tërthor (cmd) <sup>2)</sup>	≥ 13 %	
1) md = machine direction 2) cmd = cross machine direction			
<b>Qëndrueshmëria e përmasave</b>	gjatësore (md) <sup>1)</sup>	≤  0.5  %	(EN 1107-2)
	tërthore (cmd) <sup>2)</sup>	≤  0.2  %	
1) md = machine direction 2) cmd = cross machine direction			

Rezistenca ndaj grisjes	gjatësore (md) <sup>1)</sup>	≥ 300 N		(EN 12310-2)
	tërthore (cmd) <sup>2)</sup>	≥ 300 N		
1) md = machine direction 2) cmd = cross machine direction				
Rezistenca e fugës ndaj shpetëzimit	Pa dështim të fugës			(EN 12316-2)
Rezistenca e fugës ndaj prerjes	≥ 500 N/50 mm			(EN 12317-2)
Palosja në temperatura të ulëta	≤ -25°C			(EN 495-5)
Performanca në zjarr të jashtëm				(EN 1187)
	BROOF (t1) < 20°			(EN 13501-5)
Reagimi ndaj zjarrit	Kategoria E		(EN ISO 11925-2, klasifikim i EN 13501-1)	
Ndikimi i kimikateve të lëngshme, përfshirë ujin	Me porosi			(EN 1847)
Ekspozimi ndaj bitumit	Kalon <sup>3)</sup>			(EN 1548)
<sup>3)</sup> Sikaplan® TM ka kompatibilitet me bitumin e vjetër				
Rezistenca ndaj rrezatimit UV	Kalon (> 5000 orë / gradë 0)			(EN 1297)
Transmetimi i avujve të ujit	μ = 150 000			(EN 1931)
Papërshkueshmëria e ujit	Kalon			(EN 1928)
Treguesi i reflektimit të rrezatimit diellor	<b>Ngjyra</b>	<b>Fillestare</b>	<b>Vjetërsi 3 vjet</b>	<b>Instituti i testimit</b>
	RAL 9016	100	-	
Produktet e testuara nga CRRC listohen në bazën e të dhënave të Këshillit të Klasifikimit të Tarracave të Ftohta (Cool Roof Rating Council, CRRC).				
Klasifikimi sipas USGBC LEED	<b>Ngjyra</b>	<b>Fillestare</b>	<b>Vjetërsi 3 vjet</b>	(ASTM E 1980)
	RAL 9016	SRI > 82	-	
Plotëson kërkesat minimale të LEED V4 SS credit 5 option 1 Heat Island reduction - Roof.				

## INFORMACIONE MBI SISTEMIN

<b>Struktura e sistemit</b>	Mund të përdoren aksesorët e mëposhtëm: Sarnafil® T 66-15 D Sheet për detaje Sarnafil® TS 77 strips Sarnafil® T Metal Sheet Sarnafil® T Welding Cord Sarnabar® / Sarnafast® Sarnafil® T Prep / Sarnafil® T Wet Task Set Sarnacol® T 660 Solvent T 660 Sarnafil® T Clean
<b>Kompatibiliteti</b>	Sikaplan® TM-15 mund të instalohet mbi të gjitha termoizolimet dhe shtresat niveluese të përshtatshme për tarracat/çatitë. Nuk kërkohet shtresë ndarëse. Sikaplan® TM-15 është i përshtatshëm për instalim direkt mbi tarracën/çatinë bituminoze ekzistuese, të pastruar me kujdes dhe të niveluar, p.sh. hidroizolim i ri mbi tarraca/çati të vjetra të sheshta. Mund të ndodhin ndryshime të ngjyrës mbi membranë në rast kontakti të drejtpërdrejtë me bitumin.

## INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

Temperatura e mjedisit	-15 °C min. / +60 °C max.
Temperatura e nënshtresës	-25 °C min. / +60 °C max.

## UDHËZIME APLIKIMI

### CILËSIA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e njëtrajtshme, e lëmuar dhe pa dalje të mprehta apo gërvima, etj. Shtresa mbështetëse duhet të jetë kompatibël me membranën, rezistente ndaj tretësve, e pastër, e thatë dhe pa graso dhe ndryshk. Fletët metalike duhet të pastrohen nga grasoja me Solvent T 660 përpara aplikimit të adezivit.

### APLIKIMI

Punimet e instalimit duhet të kryhen vetëm nga kontraktorë të udhëzuar nga Sika për hidroizolim tarracash/ çatish.

Instalimi i disa produkteve ndihmëse, p.sh. adezivëve të kontaktit / pastruesve është i kufizuar në temperatura mbi +5°C. Ju lutemi lexoni informacionet e dhëna në skemat teknike të produkteve. Është e detyrueshme marrja e masave të posaçme për instalime nën +5°C temperaturë ambienti për shkak të kërkesave për siguri në përputhje me rregulloret kombëtare.

### METODA E APLIKIMIT / MJETET

#### Procedura e instalimit:

Sipas udhëzimeve të vlefshme për instalimin e sistemit Sikaplan® e llojeve TM për sistem hidroizolimi tarracash/ çatish me mbërthim mekanik.

#### Metoda e fiksimit:

Fleta e hidroizolimit instalohet me mbërthim mekanik me mbivendosje tegelash ose pavarisisht mbivendosjeve.

#### Metoda e saldimit:

Në rast se sipërfaqja e membranës është pak e ndotur tegelat e Sikaplan® TM-15 duhet të përgatiten me Sarnafil® T Prep. Megjithatë, përdorimi i Sarnafil® T Prep rekomandohet përpara saldimit me ajër të nxehtë. Tegelat e mbivendosjes saldohen me pajisje elektrike saldimit me ajër të nxehtë, si makineritë manuale saldimit me ajër të nxehtë dhe rulat për presion ose makineritë automatike saldimit me ajër të nxehtë me temperaturë të kontrollueshme ajri të nxehtë.

#### Lloji i rekomanduar i pajisjes:

Leister Triac për saldimit manual dhe Leister Varimat për saldimit automatik.

Parametrat e saldimit, përfshirë temperaturën, shpejtësinë e makinerisë, rrjedhjen e ajrit, presionin dhe aranzhimet e makinerisë duhet të vlerësohen, adaptohen dhe kontrollohen në kantier sipas llojit të pajisjes dhe situatës klimaterike përpara saldimit. Gjerësia efektive e mbivendosjeve të salduara me ajër të nxehtë duhet të jetë min. 20 mm. Tegelat duhet të testohen manualisht me kaçavidë për të siguruar integritetin / përfundimin e saldimit. Çdo defekt duhet të korrigjohet me saldimit me ajër të nxehtë.

## KUFIZIME

### Gjeografike / Klimaterike

Përdorimi i membranës Sikaplan® TM-15 kufizohet në vendodhje gjeografike me temperaturë mesatare mujore -50 °C. Temperatura e përhershme e ambientit gjatë përdorimit kufizohet në +50 °C.

## BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

## KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

## EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Duhet të sigurohet ventilim me ajër të freskët kur punoni (saldoni) në dhoma të mbyllura.

### REGULLORJA (EC) NO 1907/2006 - REACH

Ky produkt është një objekt siç përcaktohet në nenin 3 të rregullores (KE) Nr. 1907/2006 (REACH). Nuk përmban substanca që mund të çlirohen nga objekti nën kushte përdorimi normale ose të parashikuara arsyeshëm. Nuk nevojitet fleta e të dhënave të sigurisë në zbatim të nenit 31 të së njëjtës rregulloreje për të sjellë produktin në treg, transportuar apo përdorur atë. Për përdorim të sigurt, ndiqni udhëzimet që jepen në këtë fletë me të dhënat e produktit. Duke u bazuar në njohuritë tona aktuale, ky produkt nuk përmban SVHC (substances of very high concern / substanca me rrezikshmëri të lartë) siç renditen në Aneksin XIV të rregullores REACH apo në listën e substancave kandidatë të publikuar nga Agjencia Europiane e Kimikateve në përqëndrime më të mëdha se 0.2% (për peshë).

## SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porosinë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

### Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit

Sikaplan® TM-15

Mars 2019, Botimi 02.02

020910011000151001

SikaplanTM-15-sq-AL-(03-2019)-2-2.pdf